



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:286410

Datë: 23.10.2023

Numri i dokumentit: 04816697

C.nr. 805/2015

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.D. nga K., i përfaqësuar me autorizim nga Z.K. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës K. sh. a. në P., i përfaqësuar me autorizim nga J.M., lidhur me çështjen e kompensimit të dëmit jo material dhe material, vlera e kontestit 3.920.00-€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 09.10.2023, ndërsa me datë 23.10.2023, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit N.D. nga K.

I. DETYROHET e paditura K. sh. a. në P. në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material të shkaktuar si pasojë e shpërthimit në repartin e elektrolizës në termocentralin Kosova A në Obiliq me datë 06.06.2014, paditësit t’ia paguajë shumat si në vijim:

Në emër të dëmit jo material

- a) për dhimbje të përjetuara fizike shumë prej1.100.00-€
b) për frikën e përjetuar shumë prej.....900.00-€

Në emër të dëmit material

- a) në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë në shumë prej.....100.00-€
b) në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej.....100.00-€

II. DETYROHET e paditura që paditësit, shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguajë me kamatë ligjore prej 8%, për dëmin jo material do të rrjedh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit me datë 23.10.2023, kurse për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë 03.04.2015, e deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej gjithsej 1.404,00-€, e të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumave të gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për kompensimin e dëmit jo material

në emër të dhimbjeve fizike në shumën prej 700.00-€, në emër të frikës së përjetuar në shumën prej 800.00-€, kompensimin e dëmit material në emër të rehabilitimit fiziatriko-psikik për 10 ditë shumën prej 220.00 €, në emër të shpenzimeve procedurale për parashtrësë për precizimin e kërkesëpadisë shumën prej 104.00-€, dhe në emër të propozimit për kthim në gjendjen të mëparshme shumën prej 104.00 €.

A r s y e t i m

Paditësi N.D. nga K., i përfaqësuar me autorizim nga Z.K. avokat nga Prishtina, në këtë gjykatë me datë 03.05.2015 ka paraqitur padi duke kërkuar shpërblimin e dëmit jo material dhe material, në emër të lëndimeve trupore si pasojë e shpërthimit në repartin e elektrolizës në termocentralin Kosova A në Obiliq me datë 06.06.2014.

I autorizuari i paditësit përmes padisë dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë se saj. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 11.10.2023 e ka precizuar kërkesëpadinë dhe ka shtuar se bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve mjeko-ligjor Dr. B.I. Ortoped traumatolog dhe Dr. S.B. psikiatre të dhënë me shkrim Gjykatës dhe Udhëzuesit për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material të Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që lëndimet e paditësit në vendin e punës sipas ekspertizës mjeko ligjore janë lëndime të natyrës së lehtë trupore, ka kërkuar që në emër të dhimbjeve fizike me intenzitet të rëndë që kanë zgjatur 30 min, dhimbjeve fizike me intenzitet të mesëm që kanë zgjatur 14 ditë, dhimbjeve fizike me intenzitet të ulët që kanë zgjatur 3 muaj, shumën prej 1.800,00 €, në emër të frikës primare në formë të frikës nga vdekja që ka zgjatur disa sekonda, frikës sekondare të intensitetit të lartë për 2 ditë, frikës sekondare të intensitetit të mesëm për 3 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët që ka zgjatur 6 muaj dhe vazhdon të jetë e pranishme edhe tani shumën prej 1.700,00 €, në emër të ndihmës dhe përkujdesit të personit të tretë për 10 ditë shumën prej 100,00 €, në emër të ushqimit të përforcuar për 10 ditë shumën prej 100.00 €, në emër të rehabilitimit fiziatriko-psikik për 10 ditë shumën prej 220.00 €, gjithsej: 3.920.00 €. Ndërsa, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara u provua fakti se paditësi në ditën kritike duke punuar si punëtor fizik për furnizuesin "B.K." nga K. në ngarkim/shkarkimin e bombola të gazit CO2 sipas kërkesës se të paditurës për furnizim urgjent me CO2, për shkak të lëshimeve të paditurës në evitimin e problemeve të shfaqura teknike në pajisjet teknologjike të saja në ditën kritike ka ndodhur një shpërthim i fuqishëm në rezervuarët e Elektrolizës në "TC Kosova-A" dhe pajisjet për prodhimin e hidrogjenit në atë rast shumë punëtor në mesin e të cilëve edhe paditësi ka marr lëndime trupore. Ky fakt provohet nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor. Ka shtuar se lëshimet e palës së paditurës konsistojnë në faktin se nuk i ka eliminuar problemet teknike të shfaqura në pajisjet teknologjike të saja nga shpërthimi i të cilave janë lënduar shumë punëtor në mesin e të cilëve edhe paditësi. Me dispozitën e nenit 6 pika 3 e Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë parashihet: Punëdhënësi i përgjigjet punëmarrësit për dëmin e shkaktuar me rastin e lëndimit në punë sipas parimit të përgjegjësisë objektive të LMD-së. Në këtë rast fajësia e të paditurës supozohet, nuk shqyrtohet sepse është element i përgjegjësisë subjektive e që dallohet në raport me përgjegjësinë objektive për faktin se është përgjegjësi pa fajësi. Lidhur me

kërkesën e paditësit për kompensim demi nr.446 dt. 11.03.2015, e paditura në përgjigje të kërkesës për kompensim nuk e mohon përgjegjësinë që ka ndaj paditësit për lëndimin e tij në ditën kritike por për shkak të mos kompletimit të lëndës e orienton paditësin që për kompensim ti drejtohet gjykatës. Veprimtaria me të cilën merret e paditura prodhimi i energjisë elektrike konsiderohet si veprimtari e rrezikshme për çka shërbimi profesional i të paditurës ka qenë i obliguar që të hartoj planin i cili përfshinë analizën detale të burimeve të mundshme të rrezikut nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Ky plan ka qenë dashtë të jap shkallën e rrezikshmërisë për secilin vend te punës dhe masat preventive që duhet ndërmarre. Po ashtu, e paditura ka qenë dashtë që të ketë parasysh komplikueshmërinë teknike të pajisjeve dhe shkallën e rrezikut për punëtorët që punojnë në këto pajisje, çka në rastin konkret nuk ka ndodhur. Andaj, e paditura si pronare i përgjigjet punëtorit sipas parimit të përgjegjësisë objektive të LMD-së. Kjo nënkupton se për dallim nga përgjegjësia deliktore subjektive fajësia (kush i shkakton dëmin tjetrit me fajin e vet-përgjigjet për dëmin e shkaktuar), apo përgjegjësia për veprime të tjetrit (përgjegjësia për të tjerët) për dëmin e shkaktuar nga sendet apo veprimtaritë e rrezikshme dhe në rastet tjera të parapara me ligje të veçanta, krijohet përgjegjësia objektive për dem shpërblimin e dëmit, pavarësisht nga fajësia (neni 136 paragrafi 1 pika 2 dhe 3 e Ligjit Nr.04/-077 i për Marrëdhëniet Detyrimore). Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj precizimin e kërkesëpadisë në tërësi siç është precizuar, me kamatë ligjore 8% duke filluar që nga moment i lëndimit të paditësit e gjerë te pagesa e plotë definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë për padi shumë prej 104.00 €, në emër të propozimit për kthim në gjendje të mëparshme shumë prej 104.00 €, në emër të shpenzimeve të ekspertëve mjeko-ligjor shumë prej 200.00 €, në emër të precizimit të kërkesëpadisë shumë prej 104.00 €, në emër të ekspertizës për mbrojtje në punë shumë prej 250 €, në emër të pjesëmarrjes së avokatit në 6 seanca x 135.00 € shumë prej 810.00 €, në emër të taksës gjyqësore për padi dhe aktgjykim shumë prej 50.00 €, gjithsej shumë prej 1.622,00 €.

Përfaqësuesi i palës së paditur, në seancat e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se e kundërshton padinë dhe kërkesën e saj, për faktin se paditësi i mungon legjitimiteti real pasiv, e po ashtu, e paditura bashkërisht me Komunën e Obiliqit e ka formuar komisionin lidhur me vlerësimin e dëmeve të shkaktuara e të cilat janë kompensuar. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka shtuar se nga provat e administruara shihet qartë se paditësi i mungon baza juridike e kërkesës për faktin se paditësi padinë është dashur të ushtroj kundër punëdhënësit të vet e jo ndaj të paditurës K. sh. a. Për këtë arsye ekziston edhe mungesa e legjitimitetit real pasiv në këtë procedurë. Ka shtuar se, i kundërshton shumat e precizuara nga paditësi, për faktin se të njëjtat janë në kundërshtim me vetë lëndimet e paditësit. Gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesën e saj të refuzoj si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Kërkesën për

kompensim dëmi e datës 11.03.2015 e parashtruar nga paditësi në drejtim të paditurës K., Njoftimi i të paditurës K. lidhur me kërkesë e ushtruar me nr.446/15 të datës 25.03.2015, Raporti i lëshuar nga QKUK i datës 06.06.2014 i lëshuar në emër të paditësit, Fletë regjistri në emër të ARBK me emër të biznesit N.G. B.I. me emër tregtar NPTSH B.K., Kërkesa drejtuar PTHP dhe PK me datë 11.09.2011 nga gjyqtari i çështjes, Ekspertiza psikiatrike e datës 03.10.2019 e psikiatres Dr. S.B., Procesverbali mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi tek e paditura K. i lëshuar nga Komuna e Obiliqit i datës 20.08.2014, me nr. VI-313, Procesverbali mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi tek e paditura K. i lëshuar nga Komuna e Obiliqit i datës 20.08.2014, me nr. VI-312, Ekspertiza e datës 13.10.2019 e përgatitur nga B.I. ortoped traumatolog, Vendimi për formimin e komisionet për të analizuar avarin e shkaktuar në elektrolizën e TC Kosova A, Raporti final i datës 05.07.2017 i përgatitur nga e paditura K. lidhur me analizimin nga aspekti profesional dhe teknik i avarisë në elektrolizë, analizimi nga aspekti i sigurisë në punë, dhe nga aspekti operativ dhe operacinal, Kërkesa për informata drejtuar PTHP dhe PK me datë 13.07.2022 nga gjyqtarja e çështjes, Raporti për mbylljen e rastit me nr. KTR.I. nr. 354/14 i datës 01.03.2023 i lëshuar nga PTHP- DKR, Kontrata e punës e lëshuar nga NTPSH B.K. në emër të paditësit N.D., Aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies se punë i lëshuar nga NPTSH B.K. me datë 13.03.2020 për paditësin, dhe ekspertiza e datës 29.05.2023 e ekspertit për siguri dhe mbrojtje në punë A.K.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë çështje kontestuese në mes të palëve ishte sikurse baza juridike e kërkesëpadisë, po ashtu, edhe lartësia e saj.

Përmes kërkesës për kompensimin e dëmit e datës 11.03.2015 e parashtruar nga paditësi në drejtim të të paditurës, gjykata konstatoj se paditësi i është drejtuar me kërkesë të paditurës për kompensimin e dëmit jo material dhe material, të shkaktuar si pasojë e shpërthimit në repartin e elektrolizës në termocentralin Kosova A në Obiliq.

Nga njoftimi i të paditurës lidhur me kërkesën e ushtruar nga paditësi për kompensim dëmi me nr.446/15 të datës 25.03.2015, gjykata konstatoj se e paditura e ka refuzuar kërkesën e paditësit duke shtuar se e njëjta kërkesë nuk është e materializuar me prova të nevojshme dhe të njëjtën e ka refuzuar si të pa kompletuar, duke e udhëzuar paditësin që të shfrytëzoj rrugë të tjera për realizimin e kërkesës.

Gjykata, nga Raporti i lëshuar nga QKUK i datës 06.06.2014, konstatoj se paditësi me këtë datë ka kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën Emergjente të QKUK-së.

Përmes Procesverbaleve mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi tek e paditura K. përkatësisht të e paditura, të hartuara nga Komisioni i përberë nga anëtarët e të paditurës dhe Komunës së Obiliqit të datës 20.08.2014 me nr. VI-312 dhe VI-313, gjykata konstatoj se e

paditura ka bërë vlerësimin e secilit dëm të shkaktuar si pasojë e shpërthimit në repartin e elektrolizës në termocentralin Kosova A me datë 06.06.2014. Nga këto procesverbale, konstatohet se Komisioni i lartcekur, ka formuar listën me emra të personave të dëmtuar, dhe nga kjo listë e cila është pjesë e procesverbalit, është përcaktuar edhe lartësia e dëmit të personave që lidhet me pronën e tyre, shtëpitë dhe sende të tjera, të cilat gjinden brenda dhe jashtë lokacionit të paditurës. Në këto procesverbale, nuk gjendet emri i paditësit.

Nga Vendimi për formimin e komisionit për të analizuar avarin e shkaktuar në elektrolizën e TC Kosova A, gjykata konstatoj se e paditura ka formuar komision për të analizuar aspektin profesional dhe teknik lidhur me avarinë në elektrolizë, si dhe analizimi nga aspekti i sigurisë në punë, dhe nga aspekti operativ dhe operacinal.

Nga Raporti final i datës 05.07.2017 i përgatitur nga e paditura K. lidhur me analizimin nga aspekti profesional dhe teknik i avarisë në elektrolizë, analizimi nga aspekti i sigurisë në punë, dhe nga aspekti operativ dhe operacinal, i cili raport mbi bazën e supozimit konstaton se shkaqet e mundshme të avarisë janë: furnizimi i rezervuarëve të hidrogjenit me hidrogjen të kontaminuar, përzjerja e hidrogjenit me ajër, oksigjen, apo oksidues tjerë, arritja e kushtit për përzjerje të djegshme të hidrogjenit brenda rezervuarëve, dhe rrjedhje e hidrogjenit nga ndonjë rezervuar apo depërtimi i ajrit në rezervuarat e hidrogjenit. Po ashtu, i njëjti raport, supozon se deri të shpërthimi kanë mundur të ndikoj ekzistenca e ndonjë burimi iniciues të ndezjes së përzjerjes hidrogjen ajër apo oksigjen, të cilat kanë shkaktuar shkëndijat nga fërkimi mekanik i ndonjë vegje të punës, flakës nga pirja e duhanit apo ndezja termike, ndonjë shkarkim elektrik, burim tjetër i ndezjes nga mjete transportues, si dhe shkarkim elektrostatik nga lidhja e shkurtë e larg përçuesit apo ndonjë shkarkim tjetër elektrik. I njëjti raport arrin në konkluzion se: Gjatë ditëve 05/06/2014 dhe 06/06/2014 në TC Kosova A ka ndodhur një shpërthim dhe dy Ekspandime të Hidrogjenit dhe atë: Shpërthimi i Hidrogjenit në rezervarët e Elektrolizës së ujit për prodhimin e Hidrogjenit, me datën 06/06/2014, në ora 10:49:35, Ekspandim i Hidrogjenit në Gjeneratorin e bllokut 05/06/2014, në ora 23:30, dhe A4, me datën Ekspandim i Hidrogjenit në Gjeneratorin e bllokut A5, me datën 06/06/2014, në ora 10:49:45.

Përmes Raportit për mbylljen e rastit me nr. KTR.I. nr. 354/14 i datës 01.03.2023 i lëshuar nga PTHP – DKR, gjykata konstatoj se në momentin kur ka ndodhur shpërthimi në repartin e elektrolizës në termocentralin Kosova A, në atë moment prezent ka qenë edhe paditësi N.D., i cili sipas këtij raporti ka qenë punëtor i kompanisë B.K., e po ashtu, sipas këtij raporti i njëjti ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Përmes kontratës së punës e lëshuar nga NTPSH B.K. në emër të paditësit N.D. e datës 02.05.2013, dhe Aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i lëshuar nga NPTSH B.K. me datë 13.03.2020 për paditësin, konstatohet se paditësi me datë 02.05.2013 ka lidhur kontratë pune me kompaninë NTPSH B.K., ndërsa, nga aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i lëshuar nga NPTSH B.K. konstatohet se paditësit me datë 13.03.2020 i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të shkurtimit të vendeve të punës.

Ndërsa, për të vërtetuar rrethanën se paditësi ka pasur lëndime trupore, gjykata mori për bazë ekspertizat mjekësore, të datës 13.10.2019 e përgatitur nga B. I. ortoped traumatolog dhe ekspertizën e datës 03.10.2019 e përgatitur nga Dr. S.B. psikiatre. Ekspertët mjekësor pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit të paditësit, kanë konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të natyrës së lehtë trupore.

Të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor, kanë deklaruar se i kanë pranuar ekspertizat mjekësore, dhe për të njëjtat nuk kanë vërejtje e as pyetje, dhe nuk kërkojnë sqarime nga ekspertët. Ndërsa, gjykata të njëjtat ekspertiza i ka pranuar në tërësi si të besueshme, meqë të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, e të cilat kanë ofruar të dhëna të mjaftueshme lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore në raport me lëndimet e paditësit, ndaj dhe u'a falë besimin me rastin e vendosjes sipas padisë së paditësit.

Eksperti për siguri dhe mbrojtje në punë A.K., përmes ekspertizës së përgatitur me datë 29.05.2023 konstaton se në bazë të shkresave në lëndën e prezantuar nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë, shënimeve plotësuese të marra nga e paditura K., Raportit final të Komisionit Profesional të të paditurës K. të datës 05.07.2014, raportit, konstatimeve të lartpërmendura, shikimit të lirë në vendin e ngjarjes, konsideron se shkak i lëndimit të punëtorit, N.D., është shpërthimi i rezervuarëve të Hidrogjenit (H2) në procesin e Elektrolizës së ujit në Termocentralin "KOSOVA A". Ka shtuar se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë shënim se punëtori N.D., mund të ketë pasur ndonjë ndikim në krijimin e kushteve të ndodhjes së këtij shpërthimi. Eksperti përmes ekspertizës arrin në përfundim se pavarësisht mungesës së shënimeve për punëtorin N.D. dhe mungesës së dorëzimit të dokumenteve nga punëdhënësi i paditësit B.K., një gjë dihet se as punëtori e as punëdhënësi i tij nuk kanë ndikuar me ndonjë veprim/mosveprim që rasti i shpërthimit të rezervuarëve të Elektrolizës në Termocentralin "KOSOVA-A" të ndodhur me 06.06.2014. Prandaj, nga aspekti i sigurisë dhe mbrojtjes në punë, përgjegjësia për lëndimin e punëtorit N.D. është vetëm e të paditurës K.

Eksperti në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se qëndron prapa ekspertizës së hartuar me shkrim, duke shtuar se përgjegjës për gjendjen teknike të pajisjeve dhe makinave është punëdhënësi, në këtë rast, shpërthimi ka ndodhur për shkak të problemeve teknike në pajisjet e punëdhënësit. Në këtë seancë eksperti, po ashtu, ka deklaruar se në Raportin profesional të hartuar nga e paditura K. askund nuk thuhet se kanë shpërthyer bocat e CD 2 të cilat i ka sjellë kompania B.K., por shpërthimi ka ndodhur në rezervuarët e hidrogjenit dhe pajisjet për prodhim të hidrogjenit të cilat kanë qenë ose janë pajisje ekskluzivisht të të paditurës K.. Eksperti ka shtuar se, paditësi ka qenë i angazhuar në kuadër të kompanisë B.K. për ngarkim të bombolave në mjetin transportues nga B.K. dhe shkarkimin e tyre nga mjete transportues tek e paditura K., në kuadër të pajisjeve personale mbrojtëse i njëjti është dashur të ketë rrobat e punës, këpucët, dorëzat dhe eventualisht helmetën. Ka deklaruar se nga B.K. ka kërkuar fletë ngarkesën për pajisjet e tija mbrojtëse, por nga kompania nuk ka marrë përgjigje lidhur me këtë çështje, duke shtuar se shpërthimi ka qenë i atillë që pavarësisht faktit se punëtori i ka pasur apo jo pajisjet personale, lëndimi do të ndodhte dhe kjo nuk do të ndikonte fare në natyrën e paditësit. Eksperti ka deklaruar se nga dosja e lëndës e as nga kërkesat që kam bërë nuk kam arritur të konstatoj

nëse paditësi ka pasur pajisje mbrojtëse ose jo në momentin e shpërthimit. Njëkohësisht, ka shtuar se paditësi me asnjë lloj veprimi apo mos veprimi nuk ka ndikuar në krijimin e shkaqeve të shpërthimit në rezervuarët e hidrogjenit të të paditurës K..

Pas administrimit dhe vlerësimit të gjitha provave, dhe vërtetimit të gjendjes faktike si me lartë, gjykata gjeti se me datë 06.06.2014 në repartin e elektrolizës në termocentralin Kosova A, kishte ndodhur një shpërthim i rezervuarëve të Hidrogjenit (H₂), nga i cili shpërthim paditësi N.D. kishte pësuar lëndime të lehta trupore. Paditësi ishte i punësuar në kompaninë B.K., e cila kompani ishte kontraktuese e të paditurës K., për të furnizuar të njëjtën me boca CD 2. Shpërthimi kishte ndodhur brenda objektit të të paditurës, dhe shpërthimi kishte ndodhur si pasojë e pajisjeve të paditurës K.. Paditësi në momentin e shpërthimit ka qenë në objektin e të paditurës, duke furnizuar të njëjtën me boca të plinit CD 2.

Në bazë të provave të prezantuara dhe gjendjes faktike të vërtetuar si me lartë, gjykata vlerëson se në këtë çështje juridike kontestuese duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tani e tutje LMD).

Nga administrimi i provave të lartcekura, përkatësisht nga Raporti final i datës 05.07.2017 i përgatitur nga e paditura K. dhe nga ekspertiza e ekspertit për mbrojtje dhe siguri në punë, gjykata vlerëson së aktiviteti dhe puna të cilën e ushtron e paditura që lidhet me prodhimin e energjisë elektrike, hynë në kategorinë e punëve me veprimtari të rrezikshme.

Lidhur me këtë, neni 136 paragraf 2 i LMD-së parasheh: *“Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga fajti.”* Ndërsa, në rastet kur dëmi shkaktohet nga veprimtaria e rrezikshme, LMD-ja në nenin 154 e prezumon kauzalitetin, duke përcaktuar se: *“Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.”*

Kurse, në bazë të nenit 173 paragraf 1 të LMD-së parashihet se: *“I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur.”* Në lidhshmëri me këtë, me paragrafin 1 të nenit 179 të LMD-së përcaktohet se: *“1. Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.”* Më tutje, neni 169 paragraf 1 i LMD-së parasheh se: *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”.*

Bazuar në këto dispozita dhe në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, në rastin konkret gjykata vlerësoj se e paditura K. e bartë përgjegjësinë objektive për kompensimin e paditësit, lidhur me lëndimet e pësuar si pasojë e shpërthimit të rezervuarëve të elektrolizës në termocentralin Kosova A. Sipas rrethanave të përmendura më lartë, aktiviteti i të paditurës e përmban rrezikun në vetvete dhe subjekti që ushtron një aktivitet të tillë nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia, as duke provuar se nuk ka pasur faj në shkaktimin e dëmit, ai është i rrezikuar që në çdo moment

të mund të lindë për të përgjegjësia për kompensimin e ndonjë dëmi të ardhur si pasojë e ushtrimit të aktivitetit.

Në këtë përfundim, gjykata arriti duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit për siguri dhe mbrojtje në punë, i cili ka konstatuar se nuk ka asnjë shënim se punëtori N.D., mund të ketë pasur ndonjë ndikim në krijimin e kushteve të ndodhjes së këtij shpërthimi, i cili ka shtuar se as punëtori e as punëdhënësi i tij nuk kanë ndikuar me ndonjë veprim apo mosveprim në rastin e shpërthimit të rezervuarëve të elektrolizës në termocentralin Kosova A, dhe nga aspekti i sigurisë dhe mbrojtjes në punë, përgjegjësia për lëndimin e punëtorit N.D. është vetëm e të paditurës K.. Po ashtu, në këtë përfundim, gjykata arriti duke u bazuar edhe në Raportin final të Komisionit Profesional të të paditurës K. të datës 05.07.2014 i cili për së afërmi kishte arritur në përfundim duke vlerësuar se shpërthimi kishte ardhur si pasojë e pajisjeve dhe furnizimit të rezervuarëve me hidrogjen të kontaminuar.

Nga të lartcekurat, gjykata vlerësoj se ekziston përgjegjësia objektive e të paditurës pasi që konstatohet ekzistimin e lidhjes kauzale apo shkakësore në mes të veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Gjukata vlerëson se lidhja kauzale është një ndër kushtet për lindjen e përgjegjësisë lidhur me dëmin e shkaktuar. Në këtë përfundim, gjykata arriti pasi që konstatohet se paditësi është lënduar në objektin e të paditurës, dhe lëndimi ka ndodhur si pasojë e shpërthimit nga veprimtaria e punës së rrezikshme të cilën e ushtron e paditura, e në të cilin shpërthim paditësi nuk kishte asnjë faj apo ndikim.

Në lidhshmëri me këtë, gjykata vlerëson se dëmi i shkaktuar në lidhje me sendin e rrezikshëm ose me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ai send, përkatësisht nga ajo veprimtaria, përveç nëse argumentohet se ato nuk kanë qenë shkak të dëmit. Kjo do të thotë se për dëmin e shkaktuar nga sendi ose veprimtaria e rrezikshme supozohet se ai rrjedh nga ai send ose veprimtaria e rrezikshme, pra supozohet shkakësia ndërmjet dëmit të shkaktuar dhe sendit, përkatësisht veprimtarisë së rrezikshme. Ky prezumim do të qëndrojë derisa nuk argumentohet se ato nuk kanë qenë shkak i atij dëmi. Duke pasur parasysh faktin se për dëmin e shkaktuar nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet subjekti që merret me të, barra e të provuarit do të bie mbi subjektin që merret me veprimtarinë e rrezikshme. Ndërsa, e paditura para gjykatës nuk ka ofruar asnjë provë, për të argumentuar se shpërthimi nuk ka ndodhur nga pajisjet e saj dhe të njëjtat nuk janë shkak të dëmit.

Në këtë drejtim, gjykata e vlerësoj edhe pretendimin e të paditurës, së e njëjta nuk është e legjitimuar në këtë proces, duke shtuar se paditësi kishte kontratë punë me tjetër kompani, dhe ajo është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar. Mirëpo, bazuar në të lartcekurat, një pretendim i tillë nuk qëndron, për faktin se gjykata si më lartë e ka konstatuar lidhjen kauzale në raport me dëmin e shkaktuar, duke konstatuar se përgjegjëse është e paditura, e nga e cila lidhje kauzale krijohet edhe legjitimiteti i të paditurës në këtë procedurë.

Në raport me lartësinë e kompensimit të dëmit jo material, me paragrafin 1 të nenit 183 të LMD-së përcaktohet se: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak*

të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material". Bazuar në këtë dispozitë dhe në nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e duke u bazuar edhe në ekspertizat mjekësore, gjykata vendosi lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket kompensimit në emër të dhimbjeve fizike në emër të frikës së përjetuar, duke marr parasysh faktin se kompensimi i dëmit jo material konsiderohet si satisfaksion për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Sipas vlerësimit të ekspertes mjekësore nga lëmia e psikiatrisë, paditësi si pasojë e lëndimeve të marra ka përjetuar: frikë primare, në momentin e shpërthimit që ka zgjatë për disa sekonda e përjetuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimit direkt për integritetin e tij trupor. Po ashtu, ekspertiza ka konstatuar se paditësi ka përjetuar frikë sekondare të intenzitetit të lartë, e cila nënkupton preokupimin me gjendjen, friken, ankthin, ndrojtjen për gjendjen e tij shëndetësore, e cila ka zgjatur 48 orë, ka përjetuar frikë sekondare mesatare e cila ka zgjatur 3 muaj, dhe friken sekondare të intenzitetit të ulët, e cila ka zgjatur edhe 6 muaj tjerë dhe vazhdon të jetë e pranishme tani e kësaj dite. Bazuar në këto konstatime, dhe në konstatimin e ekspertëve se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, duke marr për bazë edhe natyrën e lëndimeve, gjykata vlerësoj se paditësi në emër të frikës së shkaktuar si pasojë e shpërthimit në repartin e elektrolizës në termocentralin Kosova A duhet të kompensohet në lartësi prej 1.100.00-€.

Ndërsa, sipas ekspertizës mjekësore nga lëmia ortopedike-traumatolog, paditësi ka pësuar lëndime trupore si shtypje të kokës, shtypje dhe gërvishtje e bërrylit të djathtë dhe shtypje e regjionit të belit. Si pasojë e këtyre lëndimeve, i dëmtuari ka përjetuar dhimbje të intenzitetit të rendë në kohëzgjatje prej 30 minuta, të cilat dhimbje kanë zgjatur nga momenti i aksidentit derisa i dëmtuari ka marre terapinë kundër dhembjes në qendrën emergjente. Paditësi ka përjetuar dhimbje të intenzitetit të mesëm për 14 ditë, dhe dhimbje të intenzitetit të ulët për 3 muaj. Ekspertiza ka konstatuar se zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë nuk ka dhe as shëmtim trupor. Bazuar në këto konstatime, dhe në konstatimin e ekspertëve se paditësi nga aksidenti ka pësuar lëndime të lehta trupore, duke marr për bazë edhe natyrën e lëndimeve, gjykata vlerësoj se paditësi në emër të dhimbjeve fizike të shkaktuara si pasojë e aksidentit duhet të kompensohet në lartësi prej 900.00-€.

Kurse, sipas ekspertizës të lartcekur mjekësore nga aspekti ortopedik- traumatolog përkujdesja nga personi tjetër ka qenë i nevojshëm për 10 ditë. Bazuar në këtë konstatim të ekspertit, gjykata vlerësoj se shuma e kërkuar nga paditësi në lartësi prej 100.00-€ është në përputhje me vlerën e cila i takon paditësit në emër të përkujdesjes nga personat e tretë, për çka vendosi që e njëjta të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Po ashtu, ekspertiza e lartcekur mjekësore nga aspekti ortopedik- traumatolog, ka konstatuar se ushqimi i përforcuar për 10 ditë i cili përfshinë ushqim të pasur me proteina, vitamina, minerale,

ka qenë i nevojshëm. Bazuar në këtë konstatim të ekspertit, gjykata vlerësoj se shuma e kërkuar nga paditësi në lartësi prej 100.00.-€ është në përputhje me nevojat e paditësit në emër të ushqimit të përforcuar, për çka vendosi që e njëjta të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si me lartë, gjykata arriti në përfundim se e paditura mban përgjegjësi për dëmin që i është shkaktuar palës paditëse nga shpërthimi në repartin e elektrolizës në termocentralin Kosova A, të cilin dëm e paditura është e obliguar të kompensoj mbi bazën e përgjegjësisë, ashtu siç përcaktohet me nenin 136 paragraf 2, nenin 154, nenin 173 paragraf 1, nenin 179 paragraf 1, nenin 169 paragraf 1, dhe nenin 183 paragraf 1 të LMD-së.

Lidhur me pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, për pjesën e refuzuar, sa i përket dëmit jo material, gjykata vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, duke marr për bazë natyrën e lëndimeve të paditësit dhe frikën e përjetuar, për çka vendosi që e njëjta të refuzohet. Ndërsa, lidhur me refuzimin e kërkesës për kompensimin e dëmit material në emër të rehabilitimit fiziatriko-psikik për 10 ditë shumën prej 220.00 €, gjykata të njëjtin e refuzoj si të pa bazuar, kjo për faktin se në shkresat e lëndës nuk kishte prova që do të argumentonin shpenzimet e tilla. Gjykata nuk e përjashton mundësin që paditësi të ketë krijuar shpenzime eventuale për nevoja të shërimit, mirëpo, i njëjti nuk ka ofruar prova lidhur me këto shpenzime eventuale të krijuara. Lidhur me këtë, LPK-ja në paragrafin 2 të nenit 7 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, e po ashtu, edhe në nenin 319 paragraf 1 të të njëjtit ligj përcaktohet se: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*.

Gjykata ka administruar edhe prova të tjera, mirëpo, të njëjtat nuk i ka vlerësuar, për faktin se nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestuese.

Vendimin mbi kamatën gjykata e bazoj në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilit: *“1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*. Për dëmin jo material gjykata e njohu të drejtën në kamatë nga momenti i përpilimit të aktgjykimit me datë 23.10.2023. Kjo për faktin se pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatën, nga momenti kur ka kuptuar për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar. Ndërsa, për dëmin material, kamatën e njohu nga momenti i paraqitjes së padisë me datë 03.04.2015, duke u bazuar në propozimin e palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bart shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 463 të LPK-së. Ndërsa, lartësinë e shpenzimeve të procedurës gjykata e bazoj në Tarifën e Odës së Avokatëve, dhe atë për padi 104.00-€, në emër të shpenzimeve të ekspertëve mjeko-ligjor shumën prej 200.00 €, në emër të ekspertizës për mbrojtje në punë shumën prej 250 €, në emër të pjesëmarrjes së avokatit në 6 seanca x 135,00 € shumën prej 810,00 €, në emër të taksës gjyqësore për padi shumën prej 40,00 €, gjithsej shumën prej 1.404,00 €.

Sa i përket shpenzimeve të kërkuara në emër të parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë në shumën prej 104.00-€, dhe në emër të propozimit për kthim në gjendje të mëparshme shumën prej 104,00 €, gjykata i refuzoj si të pa bazuara duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 453 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 paragraf 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr. 805/2015, datë 23.10.2023

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.